



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR

Nr. 96/14 Prot.

Peshkopi, më 20.01.2026

Lënda: Njoftim për shpallje fituesi.

**DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR
Z. ABAZ MUÇA**

**PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
Rruga "Qemal Stafa", Nr.1, Tiranë**

Në mbështetje të Ligjit nr 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.03.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive" i ndryshuar, Urdhrit nr.96, datë 22.12.2025, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në përfundim të vlerësimit paraprak, testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë, ju njoftojmë se për pozicionin: "Sekretar pranë Prokurorëve" në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, u vendos:

Të shpallet fitues **Z. Ermal Kryemadhi**, vlerësuar me 95 (nëntëdhjetë e pesë) pikë.

KOMISIONI

ARDITA ÇELA

AZI MUSTAFALLARI

BRONILDA DODA